



Bazuar në nenin 35 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr.03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 77/16 gusht 2010), në pajtim me nenin 4 paragrafi 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 38/24 dhjetor 2015), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 31 gusht 2017, miratoi:

## **RREGULLORE PËR LICENCIMIN E SIGURUESVE DHE DEGËVE TË SIGURUESVE TË JASHTËM**

### **Neni 1**

#### **Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktoj kushtet, kërkesat, procedurat dhe afatet që duhet ndjekur për aplikimin dhe dhënien e një licence për një sigurues/risigurues apo për një degë të siguruesit/risiguruesit të jashtëm;
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjitha subjektet që aplikojnë për licencim si sigurues/, risigurues dhe degë të siguruesit/risiguruesit të jashtëm në BQK, për të ushtruar veprimtari të sigurimeve në Republikën e Kosovës.

### **Neni 2**

#### **Përkufizimet**

1. Të gjitha termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet në nenin 3 të Ligjit nr. 05/L-045 për Sigurimet (tutje: Ligji për Sigurimet) dhe me përkufizimet si më poshtë për qëllimin e kësaj Rregulloreje.
  - 1.1. **Sigurues** - nënkupton personin juridik i licencuar për të ushtruar veprimtari të sigurimeve sipas përcaktimeve të Ligjit për Sigurime dhe kësaj rregullore;
  - 1.2. **Risigurues** – nënkupton sigurim që një sigurues (risiguruesi) blen nga një ose më shumë sigurues tjerë direkt ose nëpërmjet një ndërmjetësuesi. Risigurimi konsiderohet si një mjet i menaxhimit të rrezikut pasi që cedon rreziqet e caktuara nga një sigurues te një risigurues.
  - 1.3. **Degë e Siguruesit të jashtëm** - nënkupton degën ligjërisht të varur të siguruesit të jashtëm, i cili ka selinë kryesore në ndonjë vend jashtë Republikës së Kosovës dhe është licencuar për të ushtruar veprimtari të sigurimit në Republikën e Kosovës;
  - 1.4. **Aksionar kryesor** – nënkupton personin i cili posedon direkt apo indirekt dhjetë përqind (10%) ose më shumë të aksioneve, me të drejtë vote në një subjekt;

- 1.5. **Menaxher i lartë** - nënkupton kryeshefin ekzekutiv, zëvendëskryeshefin ekzekutiv (nëse është e aplikueshme), zyrtarin kryesor për financa, zyrtarin kryesor të marrjes në sigurim, zyrtarin kryesor për dëme, auditorin e brendshëm si dhe çdo person tjetër që i raporton drejtpërsëdrejti bordit të drejtorëve ose merr pjesë apo ka autoritet për të marrë pjesë në funksionet kryesore politikëbërëse të siguruesit; apo është caktuar si menaxher i lartë nga BQK-ja. Në rastin e degës së siguruesit të jashtëm, nënkupton menaxherin kryesor të degës, zyrtarin kryesor të marrjes në sigurim, zyrtarin kryesor të vlerësimit të dëmeve, zyrtarin kryesor financiar dhe auditorin e brendshëm.

### **Neni 3**

#### **Kërkesat për licencë**

1. Subjektet e interesuara për t'u licencuar si sigurues apo degë e siguruesit të jashtëm duhet të përmbushin të gjitha kërkesat e përcaktuara me Ligjin për Sigurimet, këtë Rregullore dhe instrumentet tjera rregullative të lëshuara nga BQK-ja.
2. Aplikuesi duhet të dorëzojë në BQK aplikacionin e plotësuar dhe të nënshkruar nga të gjithë aksionarët themelues, së bashku me përfaqësuesin i cili posedon autorizimin e aksionarëve themelues të siguruesit ose të siguruesit të jashtëm në rastet kur siguruesi i jashtëm, aplikon për licencimin e degës në Kosovë. Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentacionin e plotë që kërkohet me Ligjin për Sigurimet, me këtë Rregullore dhe instrumentet tjera rregullative të lëshuara nga BQK-ja.
3. Dokumentacioni i ofruar duhet të jetë në njërën nga gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës, qoftë në origjinal ose në kopje të legalizuar/noterizuar. Në rastin e dokumentacionit të lëshuar nga autoritetet kompetente të një shteti të jashtëm, dokumentacioni duhet të jetë i legalizuar nga autoritetet përgjegjëse të atij shteti të jashtëm dhe në përputhje me dispozitat e akteve ligjore përkatëse të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
4. Në rastet e kërkesave për licencim si degë të siguruesve të jashtëm, do të kërkohet edhe një letër sigurie e adresuar për BQK-në nga siguruesi i jashtëm amë, me anë të së cilës pranon detyrimin ligjor për pagesën e të gjitha obligimeve të degës së tij në Kosovë.
5. Përveç kërkesave të nenit 10 të Ligjit për Sigurimet, kërkesa për licencë për të themeluar dhe operuar me një sigurues ose degë të siguruesi të jashtëm, duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin dhe informacionet e mëposhtme:
  - 5.1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve në Kosovë;
  - 5.2. Dokumentin që vërteton posedimin e kapitalit themeltar dhe fondit shtesë për shpenzimet fillestare sipas përcaktimeve të nenit 19 paragrafëve 1 dhe 2 të Ligjit për Sigurimet;
  - 5.3. Programin e planifikuar për ri-sigurimin;
  - 5.4. Dëshminë e pagesës së tarifës për licencim;

5.5. Informacione tjera shtesë të cilat mund të kërkohen nga BQK-ja.

#### **Neni 4**

##### **Kapitali themeltar**

1. Aplikuesi për licencë si sigurues ose degë e siguruesit të jashtëm për të ushtruar veprimtari të sigurimeve jo jetë duhet të ketë kapital themeltar si fond garantues në vlerë jo më të ulët se dy milion e dyqind mijë (2,200,000) euro. Në rastin kur një ose disa rreziqe përfshihen në klasat 10 deri në 15 të përcaktuara me nenin 7 të Ligjit për Sigurimet, atëherë kapitali themeltar nuk mund të jetë më i ulët se në vlerën prej tre milion e dyqind mijë (3,200,000) euro;
2. Aplikuesi për licencë si sigurues ose degë e siguruesit të jashtëm për të ushtruar veprimtari të sigurimeve jetë duhet të ketë kapital themeltar si fond garantues në vlerë jo më të ulët se tre milion e dyqind mijë (3,200,000) euro.
3. Kapitali themeltar i risiguruesve të licencuar për ushtrimin e veprimtarisë së risigururimit në Kosovë, nuk mund të jetë më i ulët se tre milion e dyqind mijë (3,200,000) euro.
4. Përveç kapitalit themeltar të përcaktuar në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni, siguruesi/risiguruesi duhet të kenë edhe një fond shtesë për shpenzime fillestare, për të mbuluar shpenzimet e themelimit, funksionimit dhe administrimit, i cili në çdo rast nuk duhet të jetë më i vogël se njëzet përqind (20%) e kapitalit themeltar.
5. Aksionarët depozitojnë për llogari të siguruesit vlerën përkatëse në para të gatshme të kapitalit themeltar dhe fondit për shpenzimet fillestare, në një llogari bankare në një nga bankat e licencuara në Republikën e Kosovës. Kapitali themeltar duhet të paguhet plotësisht para marrjes së licencës përfundimtare.

#### **Neni 5**

##### **Burimet e Kapitalit**

1. Aksionarët e siguruesit/risiguruesit i ofrojnë BQK-së informacion për burimin e kapitalit të paguar për themelimin e siguruesit, si dhe për çdo shtesë të kapitalit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së siguruesit ashtu siç përcaktohet në nenin 20 dhe nenin 42 të Ligjit për Sigurimet.

#### **Neni 6**

##### **Përshtatshmëria e aksionarëve**

1. BQK-ja vlerëson përshtatshmërinë e aksionarëve kryesorë potencial, në lidhje me një aplikacion të ri për licencë të siguruesit/risiguruesit sipas kërkesave të nenit 10 dhe 24 të Ligjit për Sigurimet. Gjatë procesit të aplikimit, aplikuesi duhet të shpalosë listën e të gjithë aksionarëve themelues, si dhe pronarëve përfitues, në rastet kur janë të ndryshëm. Burimet e fondeve të investuara në kompani nga ana e aksionarëve duhet të shpalosen për BQK-në në të gjitha rastet.

2. Çdo aksionar potencial duhet të jetë në gjendje të demonstrojë qëndrueshmëri financiare, që nënkupton dëshmi të përmbushjes me kohë të detyrimeve financiare të kaluara dhe një gjendje ekzistuese të shëndoshë financiare. Secili aksionar i propozuar duhet të dorëzojë dokumentacionin valid, që vërteton pagesën me kohë të detyrimeve tatimore. Dokumenti i tillë duhet të jetë i lëshuar nga autoritetet kompetente tatimore jo më herët se 30 ditë nga data e aplikimit.
3. BQK-ja do të verifikojë në mënyrë të pavarur, të dhënat për përshtatshmërinë e aksionarëve kryesorë të siguruesit/risiguruesit. Për këtë qëllim BQK ka të drejtë të mbledhë dëshmi në pajtim me procedurat përkatëse administrative.

### **Neni 7**

#### **Kërkesat për i përshtatshëm dhe i duhur për drejtorët dhe menaxherët e lartë**

Çdo drejtor, menaxher i lartë si dhe aktuar i siguruesit/risiguruesit duhet të përmbush kërkesat për “i përshtatshëm dhe i duhur”, sipas përcaktimeve të nenit 24 të Ligjit për Sigurimet.

### **Neni 8**

#### **Kualifikimi dhe përvoja e drejtorëve dhe menaxherëve të lartë**

1. Përveç kërkesave të përcaktuara me nenin 32 të Ligjit për Sigurimet, drejtorët dhe menaxherët e lartë të duhet të kenë kualifikimet dhe përvojën si në vijim:
  - 1.1. të kenë diplomë universitare në ndonjë nga fushat si në vijim: ekonomi, financa, sigurime, jurisprudencë ose fushë tjetër relevante;
  - 1.2. të kenë së paku tri vite përvojë në fushën e menaxhimit të sigurimeve, të menaxhimit të institucioneve financiare apo të menaxhimit ndonjë biznesi të madhësisë së njëjtë.
2. BQK-ja në raste të veçanta mund të kërkojë të intervistojë individin në fjalë. BQK-ja gjithashtu vlerëson përshtatshmërinë e bordit të drejtorëve, si tërësi dhe jo vetëm anëtarët individual të tij.
3. Në rastin e degëve të siguruesve/risiguruesve të jashtëm paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni aplikohen vetëm për menaxheret e lartë të degës.

### **Neni 9**

#### **Procedura e vlerësimit të aplikacionit për licencë**

1. BQK-ja kryen shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur në pajtueshmëri me kërkesat e Ligjit për Sigurimet, kësaj Rregullore dhe instrumenteve të tjera rregullative të lëshuara nga BQK-ja.
2. BQK-ja brenda 90 ditësh pas ditës së pranimit të aplikacionit, e shqyrton dokumentacionin e dorëzuar dhe e njofton aplikuesin me shkrim nëse dokumentacioni është apo nuk është kompletuar.
3. Nëse dokumentacioni i paraqitur nuk është i kompletuar dhe/ose nuk përmbush kërkesat e përcaktuara me Ligjin për Sigurime ose këtë Rregullore, BQK-ja do të njoftojë aplikuesin

për mangësitë ose për mospërputhjet me dispozitat e Ligjit për Sigurime ose kësaj Rregullore së bashku me kërkesën për informata ose dokumente shtesë që kërkohen. Afati për paraqitjen e informatave ose dokumenteve shtesë është jo me vonë se 90 ditë pas njoftimit sipas këtij paragrafi.

4. Nëse informatat ose dokumentet shtesë të kërkuara sipas paragrafit 3 të këtij neni janë paraqitur brenda afatit, BQK do ta njoftoj palën se aplikacioni është i kompletuar.
5. BQK-ja ndërpret procedurat e shqyrtimit të aplikacionit për licencim në rast se të dhënat dhe/ose dokumentacioni shtesë i kërkuar për licencim nuk plotësohet nga aplikuesi brenda 90 ditësh pas datës së njoftimit sipas paragrafit 3 të këtij neni. Në rast të ndërprerjes së procedurës së shqyrtimit të aplikacionit për licencim, BQK-ja e njofton me shkrim aplikuesin.
6. BQK-ja nxjerr vendim me të cilin aprovon apo refuzon dhënien e licencës paraprake si sigurues ose si degë e siguruesit të jashtëm brenda tre (3) muajve nga data e njoftimit të aplikantit se aplikacioni për licencim është i kompletuar. Për vendimin e marrë BQK-ja menjëherë e informon aplikuesin.
7. Gjatë periudhës së shqyrtimit të aplikacionit BQK-ja mund të kërkojë informata shtesë apo ndryshime/përmirësime të caktuara kur vlerësohen të arsyeshme. Kërkesa për informata shtesë sqaruese në këtë fazë nuk do të ndikojë në zgjatjen e periudhës prej tre (3) muajsh për të vendosur rreth kërkesës për licencim.
8. Në çdo fazë para dhënies së licencës, BQK-ja mund të kërkojë ndryshimin e emrit të propozuar të siguruesit, po që se vlerëson se një emër i tillë do të krijojë konfuzion për publikun apo për industrinë e sigurimeve.
9. Pasi të kompletohet aplikacioni për licencë, BQK-ja vlerëson të dhënat në aplikacion dhe dokumentacionin e dorëzuar, si dhe sipas nevojës verifikon ato;
10. Nëse e vlerëson të nevojshme, BQK-ja mund të organizojë takime me përfaqësuesit e autorizuar të aplikuesit për të diskutuar rreth kërkesave të BQK-së, të cilat mund të lidhen me strategjinë e parashikuar të tregut, objektivat e paraqitura të aplikuesit, planin e parashikuar të biznesit, politikat e propozuara për menaxhimin e rreziqeve, si dhe çështje të tjera, që BQK-ja i konsideron të nevojshme për vlerësimin e këtij aplikacioni.

## **Neni 10**

### **Miratimi paraprak apo refuzimi i dhënies së licencës**

BQK vendos për miratimin paraprak apo refuzimin e dhënies së licencës sipas përcaktimeve të nenit 11 të Ligjit për Sigurimet.

## **Neni 11**

### **Njoftimi për faktet e reja**

1. Aplikuesi për licencë njofton me shkrim BQK-në për faktet ose rrethanat e reja të krijuara pas dhënies së miratimit paraprak për licencë, si dhe ndryshimet që ato sjellin në

dokumentacionin e paraqitur, mbi bazën e të cilit BQK-ja ka dhënë miratimin paraprak për licencë.

2. Njoftimi sipas paragrafit 1 të këtij neni bëhet menjëherë, por jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas paraqitjes së rrethanave të reja të aplikuesit.

## **Neni 12**

### **Licenca përfundimtare**

1. Siguruesi/risiguruesi që merr miratimin paraprak për licencë, pasi plotëson kushtet në pajtim me nenin 11 paragrafi 5 të Ligjit për Sigurimet, duhet të aplikojë me shkrim në BQK për marrjen e licencës përfundimtare së bashku me dokumentacionin i cili dëshmon përmbushjen e këtyre kushteve dhe kushteve të përcaktuara në vendimin për miratimin paraprak të licencës.
2. BQK-ja para miratimit të licencës përfundimtare kryen një ekzaminim në vend të kushteve teknike dhe të sigurisë së ambienteve, në të cilat aplikuesi do të zhvillojë veprimtarinë e sigurimeve. Qëllimi i këtij ekzaminimi është të vlerësojë nëse subjekti në fjalë ka krijuar kushte për të përmbushur detyrimet e përcaktuara me kushtet teknike për fillimin e veprimtarisë.
3. Nëse BQK-ja përcakton se janë plotësuar kushtet e përcaktuara me vendimin për licencën paraprake, do të japë licencën përfundimtare e cila është e pa afatizuar në kohë dhe është e patransferueshme.
4. Licenca jepet për klasat e sigurimeve për të cilat aplikuesi ka kërkuar të licencohet dhe i ka përmbushur kriteret e përcaktuara me Ligjin për Sigurimet dhe këtë Rregullore.

## **Neni 13**

### **Kërkesat për zgjerim të veprimtarisë**

1. Siguruesi, i cili ka marrë licencë për të ushtruar veprimtari në klasa të caktuara të sigurimit që të ushtrojë veprimtari në klasa të tjera të sigurimit duhet të marrë licencë për zgjerim veprimtarie nga BQK-ja.
1. Kërkesës për zgjerim veprimtarie (licencim të klasave tjera të sigurimet), duhet ti bashkëngjitet dokumentacioni si në vijim:
  - 1.1. Vendimin e organeve kompetente të siguruesit për zgjerim të veprimtarisë;
  - 1.2. Draft-kontratat, duke përfshirë kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës së sigurimit në përputhje me klasën e sigurimit për të cilën ka kërkuar të licencohet;
  - 1.3. Politikat e marrjes në sigurim për klasën përkatëse;
  - 1.4. Primet dhe mënyrën e kalkulimit të tyre;
  - 1.5. Parashikimin për tri vitet e ardhshme të veprimtarisë shtesë përfshirë projeksionet financiare si dhe një vlerësim mbi ndikimin e kësaj veprimtarie në gjendjen e përgjithshme financiare të siguruesit.

2. Në rastet e degëve të siguruesve të jashtëm, licencimi i veprimtarisë shtesë mund të bëhet vetëm nëse siguruesi është i licencuar për këtë veprimtari nga autoriteti mbikëqyrës përgjegjës i vendit ku ka selinë siguruesit.
3. Sipas vlerësimit të saj BQK-ja mund të kërkojë edhe dokumentacion tjetër për qëllime të shqyrtimit të kërkesave nga ky nen.
4. BQK-ja vendos për kërkesën për zgjerim veprimtarie brenda 45 ditësh nga data e kompletimit të kërkesës.

### **Neni 16** **Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për Licencimin e kompanive të sigurimeve dhe degëve të kompanive të huaja të sigurimeve, e miratuar më 30 tetor 2014 dhe çdo dispozitë tjetër që mund të jetë në kundërshtim me këtë Rregullore.

### **Neni 17** **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit të saj.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Prof. Dr. Bedri Peci